

**SHTATZËNIA** – koha gjatë së cilës nëna e mbanë fëmijën në trupin e saj deri sa të bëhet gati për lindje.

**SHTATZËNIA EKTOPIKE** – shtatzënia, te e cila qeliza vezë e fekunduar implantohet jashtë mitrës - në tubën e Fallopit.

**SIFILIZI** – SNS e shkaktuar nga bakteret.

**SIL** – sëmundje inflamatore e legenit (pelvic inflammatory disease), sëmundje që paraqitet kur infeksioni i qafës së mitrës përhapet më tej në sistemin riprodhues të femrës; shpesh shkakton dhembje kronike, shtatzëni ektopike dhe sterilitet; komplikimi më i shpeshtë i SNS-ve.

**SIMPTOMAT** – shenjat e sëmundjes.

**SINDROMA ALKOOLIKE FETALE** – grup i defekteve, të cilat ka gjasa që të paraqiten te fëmijët e nënave që kanë konsumuar sasi të mëdha alkooli gjatë shtatzënisë.

**SINDROMA E SHOKUT TOKSIK** – gjendje e rëndë shëndetësore e njohur si TSS (toxic shock syndrome), e shkaktuar nga shumimi i madh i baktereve, si rrjedhojë e përdorimit të tamponëve me veti të lartë thithëse.

**SINTETIK** – jo natyror; i prodhuar në laborator përmes reaksioneve kimike.

**SISTEMI NERVOR AUTONOM** – pjesa e sistemit nervor që i kontrollon funksionet trupore, të cilat janë jashtë vullnetit të njeriut.

**SKROTUMI** – qeskë lëkure, e lirë dhe e rrudhosur që i mban testikujt.

**SNS** – Sëmundjet ngjitëse seksuale. Cilado prej një numri sëmundjesh që mund të përhapen përmes kontaktit seksual. Sinonime: SST (sëmundjet seksualisht të transmetueshme), sëmundjet venerike, sëmundjet me bartje seksuale.

**SPERMA** – lëng i bardh qumështor që përmban spermatozoide, dhe i cili ejakulohet nga penis.

**SPERMATOZOIDI** – qeliza riprodhuese mashkullore.

**SPM (sindroma paramenstruale)** – term që përmbledh përshkrimin e gjendjes që karakterizohet me lodhje, dëshpërim, pa rahat dhe jo stabilitet emocional. Paraqitet te femrat para fillimit të periodës menstruale.

**SST** – Sëmundjet seksualisht të transmetueshme. *Shiko SNS.*

**STERIL** – i paaftë për riprodhim.

**SYNETI** – prerja kirurgjike e pjesës fundore të lafshës së penisit. Cirkumcisioni.

**TERATOJEN** – substanca të dëmshme (siç janë medikamentet, drogat, substancat kimike dhe infeksionet), të cilat mund ta dëmtojnë fetusin.

**TESTIKUJT** – organet riprodhuese të mashkullit që i prodhojnë spermatozoidet dhe testosteronin.

**TESTIKUJT E PA ZBRITUR** – gjendje gjatë zhvillimit fetal kur njëri ose të dy testikujt mbesin të palëshuara.

**TESTOSTERONI** – hormoni që prodhohet kryesisht në testikuj dhe është përgjegjës për zhvillimin dhe mbajtjen e sistemit riprodhues të mashkul-

lit.

**TORSIONI TESTIKULAR** – gjendje e cila paraqitet kur testikujt përdridhen, dhe shkaktohet ndërprerja e qarkullimit të gjakut.

**TRANSEKSUAL** – term i cili përdoret për individët që besojnë, se gjinia fizike e tyre nuk përputhet me identitetin e tyre gjinor.

**TRANSGJINOR** – *shiko* **transseksual**.

**TRANSVERSTIT** – individi që vesh rroba të gjinisë tjetër.

**TRESHJA E FEMRAVE ATLETE** – gjendje që paraqitet kur femrat ushtrojnë aq shumë, sa që ndërpriten menstruacionet; është kombinim i ushqimit të parregullt, amenoresë dhe osteoporozës.

**TRIMESTER** – termi që përshkruan periudhën prej rreth 3 muajsh gjatë shtatzënisë. Kohëzgjatja mesatare e shtatzënisë është 3 trimestra.

**TRUPI I PENISIT** – pjesa kryesore e penisit ose e klitorisit.

**TRUPI I VERDH** – strukturë në sipërfaqe të vezoreve që formohet pas pëlcitjes së folikulit dhe lirim të qelizës vezë. Pas këtij momenti fillon të sekretojë progesteron.

**TUBAT E FALLOPIT** – dy gyptha që shtrihen prej vezoreve deri në mitër.

**TUBULET SEMINIFERE** – gyptha të ngushtë, të imtë, që gjenden në testikuj, ku prodhohen dhe depozitohen spermatozoidet.

**THIMTHI** – maja e ndjeshme e gjirit, brenda së cilës hapen duktuset e qumështit.

**URETRA** – gypth përmes të cilit urina qitet jashtë trupit.

**VAGINA (vagjina)** – organ muskolor dhe elastik, e cila shtrihet prej qafës së mitrës deri te hapja e jashtme në vulvë. Ajo siguron rrugën për largimin e lëngut menstrual nga trupi i femrës; e pranon penisin e mashkullit gjatë marrëdhënies seksuale; dhe siguron rrugën për lindjen e fëmijës.

**VAGINITI** – infeksioni i vaginës i shkaktuar nga mykrat ose bakteret.

**VAS DEFERENS** – kanali dalës prej epididimisit deri në vezikulat seminale; vendi ku deponohen spermatozoidet e pjekura.

**VEZORET** – organe riprodhuese femërore, të cilat i mbajnë dhe i lirojnë qelizat vezë.

**VAZEKTOMIA** – procedurë kirurgjike me ndihmën e së cilës mashkulli sterilizohet, duke ia prerë ose lidhur vas deferens.

**VEÇORITË SEKSUALE SEKONDARE** – jo organet gjinore (gjenitalet), por shenjat tjera fizike, të cilat tregojnë për pjekurinë seksuale, p.sh., gjinjët, qimëzimi pubik, flokët, mjekra, zëri i thellë.

**VEZIKULAT SEMINALE** – xhepëza të lokalizuar mbi gjëndrën e prostatës, të cilat e prodhojnë lëngun që përbën 70% të spermës.

**VULVA** – shprehje përmbljedhëse për organet e jashtme gjinore të femrës; bëjnë pjesë mons pubis, labia majora, labia minora, klitoris si dhe hapja urinare e vaginale.

**WET DREAM** – *Shiko* **ëndrrat e lagështa**.

**ZIGOTA** – një qelizë e vetme, e krijuar pas bashkimit të një qelize vezë